




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostizur Primiheo/Prodato Received/Delivery	01.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAMSACK	2237/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.101/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktvendimin C.nr.596/2018 të datës 02.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.101/2023 të datës 19.01.2023 të parashtruar nga ankuesit

, kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 01.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.101/2023 e datës 19.01.2023 e parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesit të punësuar në pozitat Inspektor në Komunën e Podujevës, më datë 10.10.2018 kanë parashtruar kërkesë tek Shefi i Personelit i Komunës së Podujevës për ngritje të koeficientit, ndërsa Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Podujevës më atë 31.10.2022 përmes certifikatës me Nr. 13-467 ka njoftuar ankuesit që kërkesa e tyre dhe e komunës

është procedura në Ministrinë e Administratës Publike dhe do të informohen kur të vendoset nga kjo ministri.

Ankuesit me datë 09.11.2018 kanë parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë-Departamentin e Përgjithshëm-Divizionin Civil kundër Komunës së Podujevës-Drejtoratit për Inspeksion, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil përmes Aktvendimit C.nr.596/2018 të datës 02.11.2022 është shpall inkompentent për çështje lëndore dhe territoriale për të vendosje për çështjen e ankuesve, duke e hedhë poshtë si të palejueshme padinë e paditësve sepse lidhur me këtë çështje juridike kompetent është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa lënda përmes Aktit përcjellës të datës 16.01.2023 të kësaj gjykatë është përcjell në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar për regjistrim lëndën e ankuesve e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.101/2023 më datë 19.01.2023, në të njëjtën kohë më datë 31.01.2023 kemi kërkuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës lidhur me pretendimet e ankuesve, ndërsa Komuna e Podujevës më datë 10.20.2023 ka pranuar përgjigje nga Komuna e Podujevës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Akt Përcjellës C.nr.596/2018 të datës 16.01.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil; Aktvendimin C.nt.5596/2018 të datës 02.11.2022 të Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil; Padia e datës 09.11.2018 e ankuesve e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil; Certifikatën me Nr. 13-467 të datës 31.10.2018 të Udhëheqësit të Personelit; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 10.10.2018 e parashtruar nga ankuesit tek Udhëheqësi i Personelit; Listën e pagave e majit mars 2018 për ankuesit; Konkurs i datës 10.12.2015 për pozitën Inspektor i Mbrojtës së Mjedisit; Konkursin e datës 01.11.2017 për pozitën Inspektor i Tregut; Konkursin e datës 13.09.2018 për pozitën Inspektor i Pylltarisë; Certifikatë me Nr. 467 e datës 02.11.2018 të Udhëheqësit të Personelit; Listën e pagave shkurt 2016; Urdhër pagesë e datës 09.11.2018; Parashtrësën e datës 31.12.2018; Aktvendim C.nr.596/2018; Përgjigje në padi e datës 29.09.2022; Listën e pagave janar 2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2023; Përgjigje në ankese datës 10.02.2023; Akt Emërimin e datës 01.04.2014 për ankuesin R.L; Akt Emërimin e datës 03.01.2015 për ankuesin M.L; Akt Emërimin e datës 05.01.2016 për ankuesin R.C; Akt Emërimin e datës 01.04.2014 për ankuesin F.T; Akt Emërimin e datës 01.04.2014 për ankuesin Q.V; Akt Emërimin e datës 03.01.2020 për ankuesin E.A; Akt Emërimin e datës 08.02.2016 për ankuesin E.Rr; Akt Emërimin e datës 01.07.2013 për ankuesin M.Rr; Akt Emërimin e datës 05.01.2014 për ankuesin E.A; Akt Emërimin e datës 05.01.2016 për ankuesin G.D; Akt Emërimin e datës 29.02.2012 për ankuesin S.D; Lista e koeficienteve të planifikuar dhe rishikuar e datës 20.11.2018; Lista e punëtorëve që u rritet koeficienti pa datë; Lista e pagave janar 2018 deri janar 2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me këtë çështja juridike, ka konstatuar që ankesa e ankuesve është e palejuar, **SEPSE:**

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka gjetur së në kohën kur ankuesit ka filluar procedimin administrativ lidhur me pretendimet e tyre ankimore ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës sipas të cilit me nenin 81 është përcaktuar se: *1. Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë, nenin 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se: "nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës".*

Me dispozitat e nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike",* si dhe me dispozitat e nenit 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është përcaktuar se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit",* si rrjedhojë Kolegji i Këshillit referuar dispozitave të lartcekura, si dhe duke marr për bazë provat e lëndës të ankuesve dhe të dërguara nga organi i punësimit nuk ka gjetur ndonjë dëshmi përmes të cilës dëshmohet se ankuesit lidhur me pretendimet e tyre ankimore kanë parashtruar fillimisht ankesë të brendshme pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës fakt ky i konfirmuar edhe përmes përgjigjes në ankesë të datës 10.02.2023 të Komunës së Podujevës.

Duke u bazuar në këtë edhe pse ankuesit kanë ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Podujeve, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, dhe, meqenëse ankuesit nuk kanë shterur procedurat e brendshme të ankimit, sipas Kolegjit të Këshilli kjo nuk nënkupton që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të vendos në mënyrë meritore për ankesën e ankuesve për faktin që të njëjtit nuk kanë shterur procedurat e brendshme të ankimit siç parashihet m dispozitat e lartcekura, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se nisur nga ky konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankuesve është e papranueshme.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRMBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.101/2023**

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

